

V E N D I M

Per rregjistrimin ne gjykate si person juridik

Sot me date 22.11.2002, une gjyqtare ne gjykatën e rrethit ,pasi studiova materialet e paraqitura nga administratoria Fatbardha Sefa,e bija e Bajramit dhe e Lufties, lindur ne Fier me 7.8.1942,banuese ne Tirane me adrese rruga Ali Visha nr.8,me zotesi te plote juridike per te vepruar,e cila kerkon te rregjistrohet shoqeria „EL-TE-in“ sh p k si person juridik ne gjykate,

K O N S T A T O V A

Z Fatbardha Sefa kerkon te rregjistrohet ne gjykatën e rrethit Tirane shoqeria “ EL-TE-in “ sh p k duke ushtruar aktivitet privat ne fushen e :

- 1 Shfrytezimin e mineraleve te grupit te katert(gure) ne kariere,materiale per ndertim,sipas lejes se dhene nga Ministria e Industrise dhe e Energjitikes .
- 2 Pergatitja,perpunimi dhe shitja e produktit(gurit)
- 3 Tregetimi i te gjithë nenprodukteve te perpunuara te gurit,me shumice dhe me pakice,ne import eksport qe nevojiten per ndertim.

Nga shqyrtimi i dokumentave rezulton se kerkesa e saj eshte e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet pranuar,

PER KETE ARESYE

Si gjyqtare e vetme,bazuar ne nenet 37 e vijues te ligjit 7638 dt 19.11.1992 si dhe te ligjit nr 7667 dt 28.1.1993,

V E N D O S A :

Rregjistrimin ne gjykatën e rrethit Tirane si person juridik te shoqerise „ EL-TE-in “ sh p k me ortake te vetme Fatbardha Sefa e cila ka per objekt veprimtarie:


- 1 Shfrytezimin e mineraleve te grupit te katert(gure)ne kariere,materiale per ndertim,sipas lejes se dhene nga Ministria e Industrise dhe e Energjitikes.
- 2 Pergatitja,perpunimi dhe shitja e produktit(gurit)

3 Tregtimi i te gjithë nenprodukteve te perpunuara te gurit, me shumice e me pakice, import ekspert qe nevojitet per ndertim

Emertimi i shoqerise eshte "EL-TEin" sh p k shkurt "E & T"
Selia e shoqerise do te jete ne Tirane rrugen Ali Visha nr 8
Kapitali I shoqerise eshte 1000000 (njqindmije) lek
Administrator i shoqerise do te jete Fatbardha Sefa.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim.

GJYQTARE

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Dimitris Cap", written over the printed word "GJYQTARE". The signature is stylized and cursive.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
Nr 28576/1 Vendimi

V E N D I M
I G J Y Q T A R I T V E T Ë M

Sot më datën ¹⁶ /11/2005 unë gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tiranë, shqyrtova kërkesën dhe aktet e paraqitura nga kërkuësja Fatbardha Sefa me cilesinë e administratorit të shoqërisë "EL - TE -in" shpk dhe :

K O S T A T O V A

Shoqëria " EL - TE -in " Sh.p.k është regjistruar pranë rregjistrit tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tiranë me vendimin nr.28576 date.22.11.2002.

Me vendim të Ortakut të Vetem të shoqërisë date.29.09.2005 është vendosur :

1.Ortaku i Vetem Fatbardha Sefa i shet nga pjesa që ajo zoteron 30% të kuotave të kapitalit të shoqërisë z. Vladimir BREÇANI..

2.Administratori i shoqërisë do të jetë z. Vladimir BREÇANI

Ky fakt reflektohet edhe në kontratën e shitblerjes së kuotave, të hartuara ndërmjet shitesit dhe bleresit.


Kërkesa është e drejtë, e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet të pranohet.

P E R K E T O A R S Y E

Në bazë të ligjit Nr 7667 date 28.01.1993 "Për Shoqëritë Tregtare si dhe për Regjistrin Tregtar e formalitetet që duhet të plotësohen në të"

V E N D O S A

- Pranimin e kërkesës.
- Depozitim në regjistrin tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tiranë të vendimit të ortakut të vetem të shoqërisë nr 1, date 29.09.2005 të shoqërisë " EL - TE -in "shpk.
- Të depozitohet gjithashtu kontrata e shitblerjes së kuotave.
- Shoqëria do të ketë këta ortakë:
 1. Fatbardha Sefa me 70% të kuotave të kapitalit të shoqërisë dhe
 2. Vladimir BREÇANI me 30% të kuotave të kapitalit të shoqërisë.
- Administrator i shoqërisë do të jetë z. Vladimir BREÇANI.
- Të behen ndryshimet përkatëse në skedën e kësaj shoqërie në kolumnën e 2, me numer rendor 2 si dhe të ndahen regjistrimet nga njëri tjetri me vije të kuqe.
- Kunder vendimit lejohet ankimi.

GJYQTARE

Majlinda DOGGA

V E N D I M
I G J Y Q T A R I T T E V E T E M

Sot me daten 15/9/ 2006, para meje M. Dogga gjyqtare prane gjykates se rrethit gjyqesor Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e bere nga ortakët e shoqerise "EL-TE-in" shpk Tirane z. Vladimir Breçani dhe Fatbardha Sefa per depozitim ne regjistrin tregtar te vendimit nr.2 date 04.09.2006 me seli ne Tirane dhe ,

Konstatova :

Se ne baze te vendimit nr. 28576, date 22.11.2002, te gjykates rrethit gjyqesor Tirane, eshte regjistruar person juridik shoqeria tregtare e emertuar "EL-TE-in" shpk, me objekt sipas ketij vendimi.

Ne baze te vendimit nr. 1, date 16.11.2005, te ortakut te vetem te kesaj shoqerie eshte vendosur :

Shtimi I ortakut Vladimir Breçani dhe njekohesisht administrator I shoqerise "EL-TE-in" shpk Tirane

Ne baze te vendimit nr. 2, date 04.09.2006 te asamblese se ortakeve, eshte vendosur;

- Te largohet si administrator i kesaj shoqerie z. Vladimir Breçani dhe ne vend te tij te emerohet administrator I jashtem z. Petrit Breçani, I biri I Halilit dhe Mirsies, I dt/lindjes 1954, pa kuota kapitali.
- Te ndryshohet selia e shoqerise nga adresa " Rruga Ali Visha " nr. 8 Tirane nr adresen Baldushk, Tirane.

Per sa me siper, kerkesa eshte e drejte e bazuar ne ligj, dhe si e tille duhet pranuar.

Per keto arsye

Ne baze te ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare" dhe ligjit nr. 7667, date 28.02.1993 " Per regjistrin tregtar",

V e n d o s a :

Pranimin e kerkeses. Depozitimn ne regjistrin tregtar te gjykates rrethit gjyqesor Tirane te vendimit nr. 2 date 04.09.2006 te asamblese se ortakeve te shoqerise "EL-TE-in" shpk Tirane, me administrator Z. Vladimir Breçani ku eshte vendosur

- Te largohet si administrator i kesaj shoqerie z. Vladimir Breçani dhe ne vend te tij te emerohet administrator I jashtem z. Petrit Breçani, I biri I Halilit dhe Mirsies, I dt/lindjes 1954, pa kuota kapitali.
- Te ndryshohet selia e shoqerise nga adresa " Rruga Ali Visha " nr. 8 Tirane nr adresen Baldushk, Tirane.

Te depozitohet ky vendim ne regjistrin tregtar te gjykates rrethit gjyqesor Tirane.

Urdherohet zyra e regjistrin tregtar te beje veprimet perkatese.

GJYQTARE
M. Dogga

URDHER – REGJISTRIMI

1 28576

2 (a) Emertimi: "El-Te-in" shpk

(b) Selia: Tiranë, rruga Ali Visha nr 8

(c) Objekti: Shfrytëzim i mineraleve të grupit të katent (gurë), materiale për ndërtim.

(ç) Kapitali: 100.000 lekë

3. Administrator i shoqërisë Fatbardha Sefa


Ortakët Fatbardha Sefa

4. Statuti është nënshkruar me dt. 20.11.2002

5. Regjistruar me dt. 20.11.2002

Mandat Arketimi Banka e Kurtimeve, dega Tiranë
Nr. llog. 01/000011198

Gjyqtare
Amila Gopo



A K T

MBI THEMELIMIN E SHOQERISE TREGETARE „EL-TE-in” shkurt “ E & T “

SH P K



Perpilohet ky akt mbi themelimine shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar “ EL-TE-in “, shkurt “E & T ” sh p k sot me dt 20.11.2002 ne qytetin e Tiranes,sipas te cilit themeluese dhe ortake e vetme e kesaj shoqerie eshte :Fatbardha Sefa e bija e Bajramit dhe e Lutfies,lindur ne Fier me 7.8.1942,banuese ne Tirane me adrese Rruga Ali Visha nr 8,me aftesi te plote juridike per te vepruar.

Sipas ketij akti shoqeria qe themelohet do te emertohet “EL-TE-in” shkurt “E-T ” SH P K .

Ortaku i vetem i saj eshte themeluesja Fatbardha Sefa .Shoqeria do te ushtroje nje aktivitet prej me se 10 vjetesh,me te drejte zgjatje te kesaj periudhe.

Kapitali I shoqerise eshte 100000(njeqindmije) lek te depozituara nga ortaku i vetem ne Banken e Kursimeve Tirane:Ky kapital do te perfaqesohet ne shoqeri ne 100 kuota shoqerie nga 1000(njemije) lek secila.Keto kuota do te zoterohen nga ortakja ei vetme. Caktimi I kuotave ben te mundur qe ne te ardhmen,po te cmohet nga ortaku I vetem,te pranohet ne shoqeri edhe ortake te tjere.

Shoqeria mund te cele filiale dhe perfaqesi te saj brenda dhe jashte shtetit.Shoqeria do te kete per objekt veprimtarite e meposhteme:

1 Shfrytezimin e mineraleve te grupit te katert(gure) ne kariere,materiale per ndertim, sipas lejes se dhene nga Ministria e Industrise dhe Energjitikes.

2. Pergatitja ,perpunimi dhe shitja e produktit(gurit)

3. Tregitimi i te gjithë nenprodukteve te perpunuara te gurit,me shumice e pakice,ne import eksport qe nevojiten per ndertim.

Shoqeria tregtare „ EL-TE-in „ sh p k e ka seline e vet ne

Rrugen Ali Visha nr 8 Tirane.

F Sefa

Administratori i saj eshte ortakja e vetme Fatbardha Sefa.Sikurse parashikohet ne statut do te jete perfaqesuese e shoqerise,me kompetenca te plota,perderisa ne shoqeri nuk do te kete ortake te tjere,per vendimet qe meren nga Asambleja.

Shoqeria do te respektoje sa parashikohet ne aktin e themelimit,statutin e saj dhe legjislacionin qe rregullon shoqerite tregtare.

Ky akt themelimi pasi perpilohet,lexohet dhe nenshkruhet me vullnetin te lire nga themeluesja e kesaj shoqerie Fatbardha Sefa, ne prani te noterit.

Themeluesja e shoqerise „ EL-TE-in „ sh p k

Fatbardha Sefa

Fatbardha Sefa
F Sefa



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

361P rep
16P kol

PULLE TAKSE



VERTETIM

Ne Tirane sot me date 20.11.2002,para meje noterit Koco Themeli,me adrese rruga Bajram Curri pallati nr 4, u paraqit personalisht Fatbardha Sefa e bija e Bajramit dhe e Lutfies,lindur ne Fier me 7.8.1942,banuese ne Tirane me adrese Rruga Ali Visha nr 8, madhore me aftesi te plote juridike per te vepruar, e identifikuar me leternjoftimin Q H NR 346211,leshuar nga zyra e gjendjes civile Tirane,e cila me deklaroi se sa siper eshte nje akt themelimi I shoqerise tregtare “ EL-TE-in “ shpk ne te cilen eshte ortake e vetme dhe administratore e saj , e nenshkruar me vullnetin e lire dhe te plote te saj.

Une noteri vertetoi nenshkrimin e saj.

NOTERI

Koco Themeli
Koco Themeli

STATUT

I shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar“ EL-TE-in,,

Shkurt „ E & T „ sh p k

Kapitulli i pare

Objekti i veprimtarise, personaliteti juridik, selia.



Neni 1

Krijohet shoqeria tregtare “ EL-TE-in“ sh p k konform aktit te themelimit te saj te nenshkruar nga themeluesja Fatbardha Sefa, ortake e vetme.

Neni 2

Shoqeria tregtare “ EL-TE-in“ “ E & T “ sh p k eshte person juridik shqiptar. te drejtat e personit juridik ajo I fiton nga data e rregjistrimit ne gjykate.

Neni 3

Shoqeria tregtare “ EL-TE-in” sh p k e ushtron veprimtarine e saj konform statutit dhe aktit te themelimit te saj, duke respektuar kerkesat e ligjit nr 7638 dt 19.11.1992 „ Per shoqerite tregtare“ dhe ligjet e tjera te shtetit Shqiptar.

Neni 4

F Sefa

Shoqeria tregtare "EL-TE-in" sh p k do te ushtroje aktivitetin e saj per nje periudhe kohe per me teper se 10 vjet.,

Neni 5

Shoqeria tregtare "EL-TE-in" sh p k e ka seline e saj ne Rrugen Ali Visha nr 8 Tirane..Ajo ka te drejte te cele filiale te sja brenda dhe jashte shtetit,duke respektuar legjislacionin shqiptar dhe te shtetit ku do te hapen filialet.

Neni 6

Kapitali I shoqerise eshte 100000(njeqindmije) lek te depozituara ne Banken e Kursimeve Tirane.Ky kapital do te perfaqesohet nga 100 kuota shoqerie nga 1000 (njemije) lek secila.

Neni 7

Objekti I veprimtarise se shoqerise do te jete :

1. Shfrytezimin e materialeve te grupit te katert(gure) ne kariere,materiale pert ndertim,sipas lejes se dhene nga Ministrai e Industrise dhe e Energjitikes.
2. Pergatitja,perpunimi dh shitja e produktit(gurit)
3. Tregtimi i te gjithë nenprodukteve te perpunuara te gurit,me shumice e pakice,ne import eksport qe nevojiten per ndertim

Kapitulli i dyte

RSepa

Maredheniet ekonomike financiare

Neni 8

Veprimtaria e shoqerise realizohet mbi bazen e leverdise ekonomike te saj. Aktiviteti i saj ekonomik pasqyrohet ne bilancin e saj. Bilancet dhe raportet financiare te ndryshme te vitit te hartuara nga ekspertet kontabel apo administratore, i paraqiten per shqyrtim e miratim Asamblese brenda tre muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Neni 9

Viti financiar fillon nga 1 Janari te cdo vit dhe mbyllet me 31 Dhjetor. Behet perjashtim ne vitin e pare qe data e fillimit konsiderohet ajo e fillit te aktivitetit.

Neni 10

Kapitali themeltar i shoqerise eshte burimi fillestar per krijimin e fondeve te vecanta dhe fondit te xhiros. Te ardhurat neto nga bilanci ndahen:

5 deri 10 % kalojne ne fondin rezerve te shoqerise, kurse pjesa tjeter e te ardhurave i mbetet si fitim ortakur te vetem, ndersa ne rast se shoqeria do te kete ortak te tjere ajo do te ndahet ne proporcion me kuotat e kapitalit qe zoterojne ortaket ne shoqeri, me perjashtim kur prej tyre eshte vendosur ndryshe.

Neni 11

FSepa

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferushme ne rruge trashegimnie brenda familjes dhe ndermjet ortakeve(ne rast se ne te ardhmen ne shoqeri do te kete disa ortake)

Neni 12

Kur kemi transferim kuotash te kapitalit te shoqerise ne akte ndermjet te gjalleve(jo ne rruge trashegimnie) ortaket kane te drejten e parablerjes se kuotave ne shitje.

Neni 13

Kur transferimi i kuotave behet ne rruge trashegimnie e ne shoqeri jane disa ortake,trashegimtaret e ortakur te vdekur duhet te zgjedhin vete njerin prej tyre qe ti perfaqesoje ne shoqeri.

Neni 14

Ortakja e vetme mund te transferoje lirisht kuotat e kapitalit nje persone te trete,por ne rast se ne shoqeri do te bejne pjese edhe ortake te tjere,te drejten e parablerjes e kane ortaket.Kur keta nuk jane dakort qe ti blejne ato,kuotat per shitje mund ti transferohen nje personi te trete vetem me aprovimin e ortakve qe perfaqesojne jo me pak se $\frac{3}{4}$ e kuotave te shoqerise.

Neni 15



FSepa

Shoqeria mund te lidhe kontrata me persona fizike e juridike,vendas ose te huaj.Ajo per detyrimet e saj pergjigjet me kapitalin dhe te ardhurat e saj.

Kapitulli i trete

Organizimi dhe drejtimi administrativ

Neni 16

Ne kushtet e shoqerise me nje ortake te vetme vendimet e shoqerise meren prej saj.Ne se ne te ardhmen ne shoqeri do te bejne pjese edhe ortake te tjere,atehere vendimet e shoqerise do te meren nga Asambleja e Ortakeve.

Neni 17

Mbledhja e shoqerise si rregull zhvillohet ne seline e shoqerise.Kur ne shoqeri bejne pjese edhe ortake te tjere njoftimi tyre duhet te behet me shkrim te pakten 10 dite para mbledhjes e Asamblese.

Neni 18

Admimistratori i vetem i shoqerise eshte ortakja e vetme ei saj Fatbardha Sefa.Ajo gezon te drejten te perfaqesoje shoqerine prane cdo organi shteteror,privat,vendas apo te huaj,gezon te drejten te lidhe kontrata ne mer te shoqerise dhe kur e cmon te aresyshme mund te delegoje ne emer te tij e te shoqerise nje person tjeter qofte edhe si administrator dhe po keshtu mund te caktoje edhe eksperte kontabel per te pergatitur bilancet etj.



Neni 19

Personi ose administratori i deleguar mban pergjegjesi kur kapercen kompetencat qe i jane dhene nga ortakut i vetem dhe sidomos kur per shkak te ketyre veprimeve apo per shkelje te statutit ose te ligjit i sjell deme ekonomike shoqerise.

Neni 20

Vendimet e ortakut te vetem te shoqerise kane karakter ekzekutiv ne shoqeri,ashtu sikurse vendimet e Asamblese ne se ne te ardhmen ne shoqeri do te bejne pjese disa ortake.

Neni 21

Ne se ne te ardhmen ne shoqeri do te bejne pjese edhe ortake te tjere,vlen te theksohet se shoqeria nuk do te pergjigjet per detyrimet e oratekeve te saj apo te administratorit nga veprimtaria e tyre si persona fizike tej veprimtarise se shoqerise.

Kapitulli i katert


Neni 22

Shoqeria e mbyll aktivitetin e saj me perfundimin e afatit 10 vjecar,megjithate me vendim te ortakut se vetme(apo te asamblese se Jashtezakoneshme kur ka disa ortake dhe votohet,pra nga ata qe zoterojne $\frac{3}{4}$ e pjeseve te kapitalit themeltar) ky afat mund te zgjatet ose te shkurtohet.

#56ha

Neni 23

Kur mbyllet ose priset shoqeria, ajo hyn ne procesin e likuidimit. Ne kete rast ortakja e vetme(Ose Asambleja kur jane disa ortake) emeron likuidatoret, te cilet paraqesin raportin mbi gjendjen e shoqerise dhe operacionet e likuidimit.



Ne perfundim mbas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjeseve te kapitalit themeltar ortakeve, likuidatori i dorezon ortakës se vetme kapitalin e mbetur(ne rast se ka) e nese jane disa ortake ua ndan ato atyre proporcionalisht ne raport me pjeset e kapitalit themeltar qe kane patur ne shoqeri.

Neni 24

Per cka nuk parashikohet shprehimisht ne kete statut, ne aktin e themelimit te shoqerise, do te zgjidhet mbi bazen e parimeve te pergjitheshme te percaktuara ne ligjin nr 7638 dt 19.11.1992 „ Per shoqerite tregtare „ si dhe dispozitave te tjera te ligjeve perkatese.

Ky statut miratohet nga ortakja e vetme ei shoqerise Fatbardha Sefa qe e nenshkruan ate ne prani te noterit.

Ortakja e vetme

Tirane me 20.11.2002

Fatbardha Sefa

Fatbardha Sefa
FSefa

REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr 3620 rep

Nr 170 kol

PULLE TAKSE



VERTETIM

Ne Tirane sot me date 20.11.2002,para meje noterit Koco Themeli,m,e adrese Rruga Bajram Curri pallati nr 4,u paraqit personalisht Fatbardha Sefa,e bila Bajramit dhe e Lutfies,lindur ne Fier me 7.8.1942,banues ne Tirane rruga Ali Visha nr 8,madhore me aftesi te plote juridike per te vepruar ,e identifikuar me leternjoftimin Q H Nr 346211,leshuar nga zyra e gjendjes civile Tirane, e cila me deklaroi se sa siper eshte statut I shoqerise trgetare “EL-TE-in” shpk ne te ciles eshte ortake dhe administratore e vetme e saj,e nenshkrua me vullnetin e lire dhe te plote te saj.

Une noteri vertetoi nenshkrimin e saj.

NOTERI

Koco Themeli

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Koco Themeli'.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 2517 Rep.
Nr. 280/, Kol.



KONTRATE SHITJE KUOTASH

Ne Tirane, sot me daten 10/11/ 2005 (dymije e pese), para meje Mimoza PAPA, Notere me seli ne rrugen "Reshit Collaku", Pallatet e Shallvareve, u paraqiten personalisht personat e meposhtem, te cilet kerkuan hartimin e kontrates se shitjes se kuotave si me poshte :

Palet Ne Kontrate :

Ne Cilesine e SHITESIT : Fatbardha SEFA, e bija e Bajramit e Lutfijes, e datelindjes 07.08.1942, lindur ne Fier, banuese ne Tirane, e identifikuar me certifikate me fotografi Nr.99/46, madhore me zotesi te plote per te vepruar, me cilesine e ortakut ne shoqerine "EL-TE-in" Sh.P.K. Shoqeria "EL-TE-in" Sh.p.k eshte 'Person juridik' regjistruar ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare, ne Gjykatën e Shkalles se pare Tirane me Vendimin Nr.28576 date 22.11.2002. Zj. Fatbardha SEFA eshte Ortaku I Vetem dhe zoteron 100 % te kuotave ne shoqeri. Kapitali themeltar eshte 100.000 Leke (njqintmije Leke).


Ne Cilesine e BLERESIT: Vladimir BRECANI, I biri Halil e Mirsije, i datelindjes 28 Janar 1952, lindur ne Korce, banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar me Leternjoftimin EV Nr.218501.

OBJEKTI : Shitje e blerje te kuotave ne shoqerine "EL-TE-in" Sh.P.K

1. Shoqeria "EL-TE-in" Sh.p.k, eshte 'Person Juridik' krijuar me Vendimin Nr.28576 date 22.11.2002, te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane. Kapitali i Shoqerise eshte 100.000 Leke (njqintmije Leke), i ndare ne : a. Zj. Fatbardha SEFA e cila zoteron 100 % te kuotave ne vlere 100.000 Leke.
2. Shitesi Fatbardha SEFA I shet Z. Vladimir BRECANI kuotat te kapitalit ne vleren prej 30 % (tridhjetepersqint), qe ajo zoteron ne kete shoqeri.
3. Vlera e shitjes se pjeseve te kapitalit te permendura ne piken 2 me siper eshte 30.000 Leke (tridhjemije Leke). Vlera paguhet ditën e nenshkrimit te kontrates jashte zyres se Noterise. Palet nuk kane pretendime as nga shitesi as nga blesesi, te cilet deklarojne se jane likujduar totalisht te gjithë shumen , gje qe e pranojne kete fakt para meje Noterit.



FATBARDHA SEFA
FSEFA

- 
4. Me realizimin e kesaj Kontrate, Shitesi Fatbardha SEFA mbetet Ortak ne shoqeri me 70 % (shtatedhjete perqint)te kuotave te kapitalit
 5. Kuotat qe zoterojne secili prej ortakeve te kesaj shoqerie perfaqesojne pjesen perkatese qe ata zoterojne ne astetet e luajtshme dhe te paluajtshme pjese e kapitalit te shoqerise e cila ka emertimin.Me kete shitje shoqeria ka dy ortake me kuotat perkatesisht :
 - a. Fatbardha Sefa zoteron 70 %(shtatedhjete perqint) te Kuotave ne Kapitalin Themeltar te shoqerise .
 - b. Vladimir Breçani zoteron 30 % (tridhjete perqint) te Kuotave ne kapitalin Themeltar te shoqerise .

Une, Noterja, pasi ua lexova paleve kete Kontrate, u binda se nuk kishin asnje kundershtrim e nenshkruan ate me vullnetin e tyre te lire dhe te plote ne pranine time konform ligjit,une e vertetoj sipas ligjit .

Kontrata hartohet ne kater kopje origjinale .

SHITESI

FATBARDHA SEFA

FS.efa

BLERESI


Vladimir Breçani



NOTERE

Shirvan La Vepa
27/07/2005





SHOQERIA "EI-TE- in" Sh.p.k
Tirane

V E N D I M

NR.2, DATE 04.09.2006

I asamblese se ortakeve te shoqerise "EL-TE-in"sh.p.k

Tirane

Asambleja e ortakeve te shoqerise "EI-TE-in" " Sh.p.k Tirane, e mbledhur sot me daten 04.09.2006,

VENDOSI :

- Te largohet si administrator i kesaj shoqerise z. Vladimir Breçani dhe ne vend te tij te emerohet administrator I jashtem z. Petrit Breçani, I biri I Halilit dhe Mirsies, I dt/lindjes 1954, pa kuota kapitali.
- Te ndryshohet selia e shoqerise nga adresa " Rruga Ali Visha " nr. 8 Tirane nr adresen Baldushk, Tirane.


Te depozitohet ky vendim ne regjistrin tregtar te gjykates se rrethit gjyqesor Tirane.

Ortaket e Shoqerise


Fatbardha Sefa
Fatbardha Sefa

Vladimir Breçani
VENDIMIA BREÇANI

REPUBLICA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
Nr. 3704 Rep.
Nr. 2042 Kol.



Sot me daten 14/09/ 2006 para meje noterit u paraqit personalisht , ortaket e shoqerise "EI-TE-in" Shpk Tirane ,Z.Fatbardha Sefa dhe Vladimir Breçani, per identitetin e te cileve u sigurova nga dokumenti identifikues perkates te cilet deklarojne se Vendimi i mesiperm eshte perpiluar dhe redaktuar me vullnetin e lire dhe te plote te tyre, te cilen e nenshkruan para meje dhe une noteri e vertetoj sipas ligjit.



Qulle e papercor
KERKESE

H. Doga
08 SHI 08.29.2006
SHIATOR 2006

PER DEPOZITIM VENDIMI NR. DATE 04.09.2006

Kerkuesi: Fatbardha Sefa, e bija e Bajramit dhe Lutfijes dt/lindjes 1942, banuese ne rrugen " Ali Visha", nr. 8, Tirane ne cilesine e administratorit te shoqerise " EI-TE-in" shpk, Tirane, madhore e me zotest te plote juridike

-Vladimir Breçani, i biri Halilit, dt/lindje 1952, banues Tirane;

Objekti: Kerkohet depozitimi i vendimit nr. 2 date 04.09.2006 i ortakut te vetem te shoqerise "EI-TE-in" shpk.

Baza ligjore: Ligji nr. 7638, date 19.11.1992 dhe ligji nr. 7667, date 28.01.1993.

GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR TIRANE

Ne baze te vendimit nr. 28576, date 22.11.2002, te gjykates se rrethit gjyqesor Tirane, eshte regjistruar person juridik shoqeria tregtare e emertuar "EI-TE-in" shpk, me objekt sipas ketyre vendimi.

Ne baze te vendimit nr. 2 date 04.09.2006, te gjykates se rrethit gjyqesor Tirane, shoqerise "EI-TE-in" shpk eshte vendosur:

- Te largohet si administrator i shoqerise Vladimir BREÇANI dhe ne vend te tij emrohet administrator i jashtem z. Petrit Breçani, i biri Halilit dhe Mirsies, i dt/lindjes 1954, pa kuota kapitali.
- Te ndryshohet selia e shoqerise nga adresa "Rruga Ali Visha" nr. 8 Tirane nr adresen Baldushk, Tirane.
- Te depozitohet ky vendim ne regjistrin tregtar te gjykates se rrethit gjyqesor Tirane.

ORTAKET

VLADIMIR BREÇANI

[Signature]

KERKUESI:
Fatbardha Sefa

[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
Nr. 3592 Rep.
Nr. 2006 Kol.



VERTETIM

Sot me daten 02/09/2006 para meje noterit u paraqit **Fatbardha Sefa** **Vladimir Breçani** administrator i shoqerise "EI-TE-in" Shpk Tirane, i cili me identitetin e te cilit u sigurova nga dokumenti identifikues perkates te cilit deklarose kerkesa e mesiperme eshte perpiluar dhe redaktuar me vullmetin e lire dhe te plote te ciles e peshkroi para meje dhe une noterit e vertetoj sipas ligjit.



NOTERI

[Signature]

20576/13 Majlinda Dajpo
10 NENTOR 2005
K E R K E S E
Shau

KERKUESI : Fatbardha SEFA , e bija e Bajramit,e datelindjes 1942, lindur ne Fier, banuese ne Tirane, Administratore dhe Ortake e Veteme e shoqerise "EL-TE-in" Sh.p.k..

OBJEKTI : Kerkohet depozitimi ne Regjistrin Tregetar dhe pasqyrimi ne kete regjister i ndryshimit te ndodhur ne Shoqerine "EL-TE-in" Sh.p.k. , ne baze te ligjit Nr.7667 date 28.01.1993 , ligjit Nr.7632 date 4.11.1992 dhe ligjit Nr.7638 date 19.11.1992.

Perpara :

GJYKATES SE SHKALLES SE PARE TIRANE

Shoqeria "EL-TE-in " Sh.p.k. eshte person juridik ,regjistruar ne Gjykatese Shkalles se Pare Tirane me Vendimin Nr.28576 date 22.11. 2002. Shoqeria ka Ortakun e vetem zj.Fatbardha SEFA.Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 1000000 Leke.Administrator eshte zj. Fatbardha Sefa. Selia e shoqerise eshte ne Tirane ne Rrugen "Ali Visha",Nr.8.Objekti i aktivitetit eshte :

- 1.Shfrytezimin e mineraleve te grupit te katert (gure)ne kariere,materiale per ndertim,sipas lejes se dhene nga Ministria e Industrise dhe e Energjetikes.
- 2.Pergatitja,perpunimi dhe shitja e produktit (gurit).
3. Tregetimi I te gjithë nenprodukteve te perpunuara te gurit,me shumice dhe me pakice,ne import eksport qe nevoiten per ndertim.

Me Vendim Nr.1, date 29.09. 2005 , Ortaku i Vetem ka vendosur :

- Ortaku i Vetem Fatbardha Sefa shet nga pjesa qe zoteron, 30 % (tridhjetepersqint)te kuotave te kapitalit te shoqerise z. Vladimir Brecani
- Shoqeria do te kete nga keta ortake :
1. Fatbardha SEFA me 70 % (shtatedhjetepersqint) te kuotave ne kapitalin Themeltar
 2. Vladimir BRECANI me 30 % (tridhjetepersqint) te kuotave ne kapitalin Themeltar.
- Vendosjen Administrator z.Vladimir Brecani.

Nisur nga kerkesat e ligjit Nr.7667 date 28.01.1993, ligjit Nr.7632 date 4.11.1992, ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 ,si dhe neneve te Statutit te shoqerise, ju lutem te merrni ne shqyrtim kerkesen time per gjykimin e ceshtjes dhe pasqyrimin ne Regjistrin Tregetar te ndryshimeve te ndodhura ne shoqerine tone.

K E R K U E S
Administrator i Shoqerise
FATDARDHA SEFA

F.Sefa

SHOQERIA "EL- TE-in " Sh.p.k
TIRANE



PROCES VERBAL
ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE
" EL – TE –in " Sh.p.k

Ne Tirane,sot me date 29 Shtator 2005 (dymije e pese), ne seline e Shoqerise "EL-TE-in" Sh.p.k, ne rrugen "Ali Visha",Nr.8 ,Ortaku i Vetem i shoqerise analizoi :

Shoqeria " EL-TE-in "Sh.p.k ,eshte person juridik, rregjistruar ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane me Vendimin Nr.28576 date 22.11.2002.

Shoqeria ka ortakun e vetem zj.Fatbardha Sefa.

Administrator i shoqerise eshte Ortaku i vetem Fatbardha Sefa,

Kapitali Themeltar eshte 100.000 Leke.

Selia ndodhet ne Tirane,ne rrugen "Ali Visha",Nr. 8.

Ortaku I Vetem vendosi :

**VENDIM Nr. 1 , dates 29.09.2005 i Asamblese se Jashtezakoneshme
te Ortakut te Vetem te Shoqerise "EL-TE-in" Sh.p.k**

- Ortaku i Vetem zj.Fatbardha Sefa, i shet z. Vladimir Brecani 30 %(tridhjete perqint) nga kuotat e saj .
- Vendorsjen Administrator z. Vladimir BRECANI .

Sipas Ligjit Nr. 7638 dt. 19.11.1992 "Per shoqerite Tregtare " , ky vendim duhet te depozitohet prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane ne Regjistrin Tregetar , per te bere ndryshimet e reja per shoqerine "EL-TE-in" Sh.p.k.

ORTAKU I VETEM

FATBARDHA SEFA

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'F Sefa'.

K E R K E S E

3 A. Cope
92 11. 2002
NOV. 2002

G J Y K A T E S S E R R E T H I T

T I R A N E

Une e nenshkuara :
Fatbardha Sefa, e bija e Bajramit dhe e Lutfies, lindur ne Fier me
7.8.1942, banuese ne Tirane ne Rrugen Ali Visha nr 8, paraqes perpara
gjkates se rrethit Tirane kerkesen e meposhteme :

Me aktin e themelimit te dates 20.11.2002 eshte krijuar shoqeria
tregtare " EL-Te-in ,, sh p k shkurt ,, E & T ,, dhe si ortak e vetme e saj
jam njekohesisht edhe administratorja e shoqerise.

Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, ligjin ,, Per Shoqerite
Tregtare " dhe ligjin " Per Rregjistrin tregetar dhe formalitet qe
duhen respektuar per shoqerite tregtare " kerkoj nga gjykata
rregjistrimin e shoqerise si person juridik ne rregjistrin tregetar.

Bashkalidhur ju paraqes :

1. Aktin e themelimit te shoqerise
 2. Statutin e shoqerise
 3. Depozitimin e kapitalit te nevojshem ne banke
- Kerkoj qe kerkesa te meret ne konsiderate.

K E R K U E S E

Administratorja

Fatbardha Sefa

Fatbardha Sefa
Sefa

PULLE TAKSE



100
LEKE

R.SHQIPERISE

PULLE TAKSE



100
LEKE

R.SHQIPERISE

PULLE TAKSE



100
LEKE

R.SHQIPERISE

PULLE TAKSE



100
LEKE

R.SHQIPERISE


PULLE TAKSE



100
LEKE

R.SHQIPERISE

R.SHQIPERISE



PULLE TAKSE

R.SHQIPERISE



PULLE TAKSE

R.SHQIPERISE



PULLE TAKSE

R.SHQIPERISE



PULLE TAKSE

R.SHQIPERISE



PULLE TAKSE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

PULLE TAKSE

Nr 3618 rep

Nr 168 kol



VERTETIM

Ne Tirane sot me date 20.11.2002,para meje noterit Koco Themeli,me adrese rruga Bajram Curri pallati nr 4,u paraqit personalisht Fatbardha Sefa,e bila e Bajramit dhe e Lutfies,e dt 7.8.1942,lindur ne Fier,banuese ne Tirane rruga Ali Visha nr 8,madhore me aftesi te plote juridike per te vepruar,e identifikuar me leternjoftimin Q H Nr 346211,leshuar nga zyra e gjendjes civile Tirane,e cila me deklaroi se sa siper eshte nje kerkese,drejtuar gjykates se rrethit Tirane per rregjistrimin si person juridik te shoqerise tregetare „ EL-TE-in“ shpk,ne te cilen eshte ortake dhe administratore e vetme e saj,e bebshkruar me vullnetin e lire dhe plote te saj.

Une noteri vertetoi nenshkrimin e saj.

NOTERI

Koco Themeli

